

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PRO VIMI I MATURES SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DEJYRUAR)

VARIANTI A

E martë, 2 qershor 2009

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme artistike; koreografe; sportive; me kohë të shkurtuar

Udhëzime përnxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Përpërdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10a	10b	11a	11b
Pikët														
Kërkesa	11c	12	13a	13b	13c	13d	14	15	16	17	18	19	20a	20b
Pikët														
Kërkesa	20c	21	22a	22b	22c	23a	23b	23c	24	25a	25b	25c	25d	
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I

Gjergj Elez Alija
(fragment)

Sa ka nisun drita me zbardhë majet,
n'fushë t'mejdanit trimat konkan dalë,
keq me fjalë trimat shoshojnë po rrekin:
“P'a prej vorrit, Gjergj, ti konke çue?
Pse me m'qitë, bre burrë, n'kët fushë t'mejdanit?”
Sa mirë trimi i ka përgjegjë Balozit:
“ Të lumtë goja, Baloz, mirë po thue,
qe nandë vjet qi kam marrë rrugn' e vorrit,
pak pa mrrijtë, Baloz, ti m'ke dredhue:
m'ke lypë motrën para se mejdanin,
m'ke lypë berrat para se çobanin,
e jam dredhë n'kët log për me t'kallxue
se ne t'parit' një kanu na kanë lanë:
armt' me dhanë përpara e mandej gjanë,
kurr Balozit motrën mos m'ia dhanë,
për pa u pre n'at fushën e mejdanit!
Por shtrëngohu, Baloz, se t'ka ardhë dita,
se ktu i thonë-o Gjergj Elez Alija!”
E i kanë ba dy gjogat tim për tim
e n'topuz Balozit e ka shinue:
n'dy gjujt gjogu Gjergjit te i ka ra,
përmbi kryet topuzi i ka fjurue;
dymbdhetë pash n'ledinë u ngul topuzi,
dymbdhetë pash përpjetë si re u çue pluhni.
At'herë Gjergjit rendi te i ka ardhë,
sa mirë trimi n'topuz qi ka dredhë,
lik përmyet Balozit te i ka ra.
A'trandë fusha kur a'rrxue Balozit.
Mejherë trimi shpatën ma ka xjerrun,
kryet me neje trupit ia ka damun,
zhag për kambet trupin e ka ngrehun,
me gjith at m'nji bunar e ka mbytn.
Të tanë lumën gjaku e ka tërzue,
për tri vjet krejt vendin e ka qelbun.

Për pyetjet 1-7 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Kënga e Gjergj Elez Alisë bën pjesë në:

1 pikë

- A) këngët legjendare të rinjohjes.
- B) këngët e ciklit të kreshnikëve.
- C) këngët legjendare të murosjes.
- D) këngët legjendare të vëllait të vogël.

2. Fjalët kyç: *trim, shpatë, topuz, gjak, mejdan* krijojnë imazhin se në këtë fragment: **1 pikë**
- A) ndodh një dyluftim i ashpër.
 B) debatohet mbi llojet e armëve.
 C) lidhet një vëllazëri e përjetshme.
 D) ekzekutohet një rit i vjetër pagan.
3. Prania e Balozit në këtë këngë tregon: **1 pikë**
- A) vlera të padiskutueshme njerëzore.
 B) harmoni mes së mirës dhe së keqes.
 C) ekzistencën e kundërshtarit përbindësh.
 D) kundërvënien e njeriut me Perëndinë.
4. Folja në vargun “*n’fushë t’mejdanit trimat konkan dalë*” është në mënyrën: **1 pikë**
- A) kushtore
 B) dëftore
 C) lidhore
 D) habitore
5. Anafora në vargjet: “*Dymbdhetë pash n’ledinë u ngul topuzi/ dymbdhetë pash përpjetë si re u çue pluhni*” është fjalë: **1 pikë**
- A) e prejardhur
 B) e përbërë
 C) e përngjitur
 D) e parme
6. Vargu që sjell rrjedhën e ngadaltë të kohës, përmes simbolikës popullore, është: **1 pikë**
- A) sa ka nisun drita me zbardh majet.
 B) qe nandë vjet qi kam marrë rrugn’ e vorrit.
 C) n’fushë t’mejdanit trimat konkan dalë.
 D) por shtrëngohu, Baloz, se t’ka ardhë dita.
7. Dyluftimi në këtë fragment ju sjell ndër mend skenën e famshme të ndeshjes së: **1 pikë**
- A) Akilit me Hektorin.
 B) Skënderbeut me Ballabanin.
 C) Makbethit me Makdabin.
 D) Orestit me Egistin.
8. Fjalët e mëposhtme, të shkëputura nga fragmenti, i shkruani në gjuhën standarde. **2 pikë**
- a) *përgjegjë*: _____
 b) *dredhue*: _____

9. Në vargun: “ *të lumtë goja, Baloz, mirë po thue*” shprehja *të lumtë goja* krijon efekt për shkak të kuptimit të veçantë me të cilin është përdorur. Cili është ky kuptim dhe me cilën figurë të fjalës realizohet?

a) kuptimi: _____

1 pikë

b) figura: _____

1 pikë

10. Në këngët e epikës legjendare, peshën kryesore figurative e mban hiperbola. Gjeni në pjesën e mësipërme dy të tilla dhe interpretoni rolin e tyre në funksion të brendisë.

a) hiperbola 1: _____

2 pikë

hiperbola 2: _____

b) interpretimi: _____

1 pikë

11. Në fragment kemi rima foljore dhe emërore. Gjeni nga një shembull për secilin rast dhe shpjegoni efektin e tyre.

a) rimë foljore: _____

1 pikë

b) rimë emërore: _____

1 pikë

c) efekti: _____

1 pikë

12. Evidentoni tre momente kyç të brendisë së fragmentit, duke ndjekur rendin kronologjik të ngjarjes.

3 pikë

a) _____

b) _____

c) _____

13. Gjergji i drejtohet Balozit duke i dhënë arsyen përse ndodhet përballë tij. Cila është kjo? Në cilin kod moral mbështetet? Interpretoni vargun që e jep këtë.

a) arsyeja: _____

1 pikë

b) kodi moral: _____

1 pikë

c) vargu: _____

1 pikë

d) interpretimi: _____

1 pikë

PJESA II

Heminguej

Lamtumirë armë (fragment)

Ky fragment është shkëputur nga romani Lamtumirë armë i Ernest Heminguejit. Jemi në pjesën e parë të romanit. Henri, personazhi kryesor është plagosur në luftë. Tashmë, ai ndodhet në spital.

- Ç'keni kështu, uratë?- tha Henri. Më dukeni shumë i lodhur.

- Jam i lodhur dhe nuk kam të drejtë të jem.

- Ndofta nga vapa.

- Jo, nga shkaku i pranverës. E ndjej veten si të dërrmuar.

- Jeni i trishtuar.

- Jo, por urrej luftën.

- As unë nuk e dua,- i thashë.

Ai tundi kokën dhe vështroi nga dritarja.

- Ajo ju prek pak. Ju nuk e shihni. Më falni. E di mirë që jeni plagosur.

- Ndodhi një aksident.

- Megjithatë, ndonëse jeni plagosur, nuk e shihni. Unë mund të flas për luftën. Unë vetë nuk e shoh por e ndjej...pak.

- Ne flisnim pikërisht për luftën në çastin që u plagosa. Passini fliste për luftën.

Prifti la gotën. Ai mendonte për tjetër gjë.

- Grada juaj është gradë oficeri, edhe unë jam oficer.

- Në të vërtetë nuk jam, kurse ju, ju nuk jeni italian. Ju jeni i huaj. Por ju jeni më afër oficerëve se njerëzve.

- Cili është ndryshimi?

- Është vështirë ta thuash. Ka njerëz që janë partizanë të luftës. Në këtë vend ka shumë . Ka të tjerë që janë kundra.

- Po.

- Dhe unë i ndihmoj.

- Ju jeni i huaj. Ju jeni patriot.

- Po ata që janë kundër luftës a mund ta ndalin?

- Nuk e di.

Ai vështroi përsëri nga dritarja dhe unë po vështroja me vëmendje fytyrën e tij.

- A kanë qenë ndonjëherë të zotë të ndalin luftën?

- Ata nuk janë të organizuar për t'i ndalur gjërat dhe, sa herë që arrijnë të organizohen, shefat e tyre i shesin.

- Atëherë nuk ka asnjë shpresë?

- Shpresë ka gjithmonë. Po nganjëherë e humbas shpresën. Mundohem gjithmonë të kem shpresë por nganjëherë nuk dëshpërohem.

- Lufta do të marrë fund ndofta.

- Kam shpresë.

- Ç' do të bëni atëherë?

- Po të jetë e mundur do të kthehem në Abrucet...

Tani duhet të ngrihem e të iki, me gjithë mend e kam, - tha ai.- Vërtet nuk keni nevojë për asgjë? – më pyeti me një dritë shprese në sy.

- Jo, kam nevojë vetëm për të biseduar.

- Do t'u bëj të fala të gjithëve në mensë nga ana juaj.

- Ju faleminderit për dhuratat tuaja të bukura.
- Ju lutem.
- Ejani të më takoni prapë.-Po, Lamtumirë.- Më ra lehtë në dorë.
- Mirupafshim,-thashë në dialekt.

Brenda në dhomë ishte errësirë dhe ordianca, që ishte ulur te këmbët e shtratit, u ngrit dhe doli bashkë me të. E doja shumë priftin dhe dëshiroja me gjithë zemër që një ditë të mund të kthehej në Abrucet. Në mensë tregohej i gëzuar dhe pse nuk i nënqeshte fati, por unë mendoja se ç’jetë të bukur mund të kalonte në vendin e tij. Ai më kishte thënë se në Kaprakota, jashtë qytetit, tatëpjetë lumit kishte trofta në lumë. Natën ishte e ndaluar t’i bije fyellit. Kur djemtë e rinj bënë serenatë vetëm fyellit nuk mund t’i bije. Pyeta për ç’arsye. Më kishin thënë se tingulli i fyellit, natën, është i rrezikshëm për vajzat e reja. Fshatarët i quanin të gjithë të rinjtë “ Don” dhe hiqnin kapelën kur kalonin ata. Babai i tij shkonte në çdo meshë dhe hante te fshatarët. Ishte gjithmonë një nder i madh për ta. Një i huaj nuk mund të dilte për gjah po të mos kish një certifikatë ku të thuhej se nuk kish qenë kurrë në burg. Në Gran Sasso d’Italia kishte arinj, por ai vend ishte larg. Akuila ishte një qytet i bukur. Në verë netët ishin të freskëta dhe pranvera e Abruceve ishte pranvera më e bukur e Italisë. Por gjëja më e këndshme që vjeshta, stina e gjahut në pyjet e gështenjave. Të gjithë zogjtë e kishin mishin të shijshëm, sepse ushqeheshin me rrush dhe s’kishte kurrë nevojë të merrje drekën me vete, sepse fshatarët e quanin si nder të madh po t’u shkoje për drekë. Pas një copë here më zuri gjumi.

Për pyetjet 14-19 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

14. Në këtë roman kemi:

1 pikë

- A) një histori dashurie në një botë ku sundon ligji i luftës.
- B) një histori miqsh që bëjnë kompromise të çuditshme.
- C) një histori të rinjsh që shkojnë për t’u argëtuar.
- D) një histori njerëzish që luftojnë pafundësisht kundër njëri-tjetrit.

15. Konstatimi që e identifikon autorin si shkrimtar i brezit të humbur, gjendet në thënien:

1 pikë

- A) ishte e ndaluar t’i bije fyellit.
- B) e ndjej veten si të dërrmuar.
- C) kam nevojë vetëm për të biseduar.
- D) nganjëherë e humbas shpresën dhe e urrej luftën.

16. Kuptimi i zgjeruar i titullit *Lamtumirë armë* është:

1 pikë

- A) nuk do të shihemi për një kohë të gjatë.
- B) po shkoj dhe do të kthehem përsëri.
- C) po iki nga lufta për të mos u kthyer më kurrë.
- D) po shkoj në shtëpi për të festuar me miqtë.

17. Nevoja e Henrit për të biseduar vazhdimisht me priftin buron nga fakti që:

1 pikë

- A) ai ishte i plagosur.
- B) ai ishte i huaj.
- C) atë e tërhiqte tema e bisedës.
- D) ai ishte patriot.

18. Fjala *lamtumirë* bën pjesë në fushën leksikore të:

- A) përshëndetjeve
B) urimeve
C) mallkimeve
D) profesioneve

1 pikë

19. Stili i Heminguejit karakterizohet nga thjeshtësia, sepse:

- A) temat e zgjedhura janë të vështira.
B) momentet e forta e kanë të vërtetën brenda tyre.
C) ngjarjet janë marrë nga historia e largët.
D) ngjarjet dhe personazhet janë thjesht krijim i fantazisë.

1 pikë

20. Si ndihet prifti në fillim të fragmentit? Shpjegoni arsyen e kësaj gjendjeje duke e mbështetur me një detaj.

- a) si ndjehet: _____
b) arsyeja: _____
c) detaji: _____

1 pikë

1 pikë

1 pikë

21. Henri në fragment shfaqet në dy plane: si soditës dhe si pjesëmarrës.
Ku shfaqet secili prej tyre?

- a) soditës: _____

b) pjesëmarrës: _____

2 pikë

22. Në cilat vende shëtit fantazia e Henrit në paragrafin e fundit? Përse ndodh kjo?
Ilustroni me detaje arsyen e dhënë.

- a) vendet: _____
b) arsyeja: _____
c) ilustrimi: _____

1 pikë

1 pikë

1 pikë

23. Ç'stil ligjërimit është përdorur në fragment? Identifikoni dy tipare të tij, duke i shpjeguar me shembuj.

- a) ligjërimit: _____
b) tipari 1: _____; shembull: _____
c) tipari 2: _____; shembull: _____

1 pikë

1 pikë

1 pikë

24. Cila është shenja e pikësimit karakteristike për dialogun në këtë fragment?

_____ 1 pikë

